



- [Të Reja](#) [Policia e Shtetit](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet e policisë](#) [Video](#) [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#)
- [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore të Policisë](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rugore](#) [Donacione](#)
- [Rubrika Policimi në Komunitet](#) [Përmbledhja Javore](#)

Lajmet e Fundit: DVP Elbasan – Vihen në pranga 2 drejtues mjetesh. Procedohen penalisht 5 shtetas të tjerë

⏮ ⏪ ⏩ ⏭



01/06/2022

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Komuna”

Operacioni, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje.

Operacioni, i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Nr. 2, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme “Shqiponja”.

Lëvizte me armë zjarri me vete, vihet në pranga 20-vjeçari.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë, një krehër dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 2, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme “Shqiponja”, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, se në Komunën e Parisit, po lëvizte një shtetas i armatosur, kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar me sukses operacionin policor të koduar “Komuna”.

Si rezultat i këtij operacioni u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

– S. T., 20 vjeç, banues në Dobraq, Shkodër, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”.

Në Komunën e Parisit, shërbimet e Policisë kanë konstatuar shtetasin S. T., i cili sapo ka vënë re shërbimet e Policisë, ka tentuar të futet në një taksì. Pasi është ndaluar, gjatë kontrollit të një çante lëkure që 20-vjeçari kishte me vete, janë gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri pistoletë, një krehër dhe municion luftarak.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

- Linqe
- >

Arkiva
- >

Akademia e Sigurisë
- >

Ministria e Brendshme
- >

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- >

Interpol
- >

Europol
- >

Misioni PAMECA V
- >

SCPA
- >

Projekti Trivalent

- Share
- Share
- Share
- Share
- Email

◀ DVP Vlorë/Procedohen në gjendje të lirë 6 shtetas, për vepra të ndryshme penale

DVP Elbasan – Vihen në pranga 2 drejtues mjetesh. Procedohen penalisht 5 shtetas të tjerë ▶